



Republika e Kosovës
Republika Kosovon - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit

Mbledhja nr. 04

Prishtinë, më 10.6.2015, në orën 9:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N 302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Armend Zemaj, Selville Halimi, Albulena Haxhiu, Danush Ademi dhe Enver Hoti.

Munguan: Donika Kadaj-Bujupi dhe Milena Miliçević.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Driton Selmanaj, KDI; Visar Rushiti, GAP; Kaltërina Ahmeti, GLPS; Shefki Kastrati, NDI; Erdi Pirana dhe Gentiana Dushi-praktikantë.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Armend Zemaj, kryetar i Nënkomisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Hartimi i Projektligjit për Kuvendin e Republikës së Kosovës;
3. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Hartimi i Projektligjit për Kuvendin e Republikës së Kosovës

Kryetari, tha se do të vazhdojmë me kreun III, t'i diskutojmë dispozitat e radhës për aq sa do të mundemi, dhe siç kam theksuar edhe takimin e kaluar, drafti përfundimtar do të jetë gati pas punëtorisë që e kemi paralajmëruar. Ne kemi marrë rekomandime nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike dhe Instituti GAP dhe si komision, të shohim se cilat prej tyre mund t'i përkrahim.

Gjatë këtij takimi u diskuan dispozitat e projektligjit nga neni 4, deri tek neni 17. Lidhur me nenin 5, ku flitet për aktet e Kuvendit, nuk kishte ndryshime, pasi që ky nen u kërkua që të analizohet edhe më tej dhe të shikohet edhe projekt-rregullorja që ka mbetur në procedurë nga legjislatura e kaluar, sepse kështu siç është formuluar, është shumë e paqartë, tha kryetari. Ndryshime u bënë në nenin 7.1, 8, 9, kurse neni 10 u kërkua të fshihet në tërësi dhe neni 11 u riformulua. Lidhur me këto ndryshime, diskutuan edhe Selvije Halimi, Albulena Haxhiu dhe Enver Hoti.

Në fund të takimit, Nënkomisioni vendosi që kreu VI, që flet për bashkëpunimin e Kuvendit dhe Qeverisë për sa i përket çështjeve të integritetit evropian, t'i dërgohet Komisionit për Integritet Evropian për koment dhe kërkohet që këto komente të bëhen më së largu deri më datën 19.6.2015.

3. Tëndryshme

Takimi i radhës së Nënkomisionit u caktua më 11.6.2015, në orën 14:00.

Mbledhja përfundoi në orën 10:05.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Nënkomisionit

Armend Zemaj